

Instruksiione mbi Licencimin e agentëve në sigurime

1. Të përgjithshme

- Veprimtaria e agentëve dhe shoqërive të agentëve përfaqëson një veprimtari ndërmjetësimi në sigurime që ushtrohet nga persona fizik apo juridik të licencuar.
- Agjenti apo shoqëria e agentëve vepron në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit.
- Agjenti apo shoqëria e agentëve e licencuar ushtron veprimtari vetëm në emër të një shoqërie sigurimi, me përjashtim kur në kontratën midis agentit dhe shoqërisë së sigurimit është parashikuar ndryshe.
- Agjenti apo shoqëria e agentëve nuk lejohet të ushtrojnë njëkohësisht veprimtari ndërmjetësimi në sigurimin e jetës dhe të jo-jetës.
- Veprimtarinë e agentit në sigurime mund ta ushtrojnë edhe ente të tjera që kryejnë veprimtari në fushën e shërbimeve me kusht që veprimtaria e agentit në sigurime të ushtrohet në emër të tyre nga agentë të licencuar nga AMF.

2. Dokumentacioni që shoqëron kërkesën për aplikim

Çdo aplikant, në faqen e internetit të AMF, do të gjejë Formularin e aplikimit për pajisjen me licencë “agjentë në sigurime”.

Formulari shoqërohet nga dokumentacioni si me poshtë.

- Dokumentacioni që duhet të plotësojnë aplikuesit për licencë agjenti si **person fizik** janë:

A. Kriteret e besueshmërisë

Kriteret	Dokumenti
a. Dokument identifikimi që vërteton zotësinë e plotë për të vepruar	Certifikatë personale me fotografi e periudhës jo më e vjetër se tre muajt e fundit para aplikimit, pasaportë, letër njoftimi
b. Të ketë vërtetim të gjendjes gjyqësore, ku të rezultojë i padënuar për vepra kriminale ndaj pronës, vepra të krimit ekonomik, veprimtari të paligjshme	Vërtetim i gjendjes gjyqësore, lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, ose formulari i vetëdeklarimit
c. Të mos jetë debitor në organet tatimore	Vërtetim nga organet tatimore
d. Të mos jetë debitor ndaj shoqërisë së sigurimit	Vërtetim nga shoqëria e sigurimit
e. Të mos jetë i punësuar në një shoqëri sigurimi	Vërtetim nga shoqëria e sigurimit ose deklaratë personale

f. Të mos ketë qenë anëtar i këshillave mbikëqyrëse apo drejtues i shoqërive në proces falimentimi a likuidimi	Deklaratë personale
g. Të disponojë mjedisin dhe infrastrukturën e përshtatshme për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime (Zyrë e përshtatshme, e pajisur me kompjuter dhe akses për lidhje on-line me shoqërinë e sigurimit)	Dokument hipotekor për pronësinë e ambientit, kontratë qiramarrje, foto për ambientin dhe pajisjet e saj
h. Të ketë një garanci financiare në masën 4% të shumës së primeve vjetore të mbledhura ose të paktën shumën prej 500 000 (pesëqind mijë) lekë në një nga bankat e nivelit të dytë që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë në favor të shoqërisë së sigurimit, më të cilën do të lidhë kontratën e agjentit	Vërtetim bankar
i. Të ketë kontratë me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të së cilës vepron	Kontrata e nënshkruar nga të dy palët.
j. Të ketë policë siguri për përgjegjësitë profesionale në një shumë jo më të vogël se 100 000 lekë për çdo ngjarje të siguruar ose jo më të vogël se 150 000 lekë në vit për të gjitha rastet e sigurimit	Polica e sigurimit

B. Kriteret e aftësisë profesionale

Kriteret	Dokumenti
a. Të ketë kryer të paktën arsimin e mesëm	Diploma e shkollës që vërteton arsimin e kryer
b. Të ketë kryer kualifikim profesional	Dokument për kryerjen e një kualifikimi pranë një instituti trajnimi në sigurime brenda ose jashtë vendit me një program të njohur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ose programin e trajnimit së bashku me rezultatet e testimeve, të cilat gjykohen nga AMF
c. Të zotërojnë njohuri bazë në kompjuter	Dokument që vërteton njohuritë bazë në përdorimin e kompjuterit

- Kriteret dhe dokumentacioni që duhet të plotësojnë aplikuesit për licencë agjenti si **person juridik** janë si më poshtë:

Kriteret	Dokumenti
a. Formular kërkesën për pajisjen me licencë agentë në sigurime	Formular kërkesën e miratuar nga Autoriteti
b. Të jetë shoqëri anonime e krijuar për kryerjen e aktivitetit të agentit në sigurime, ose shoqëri me aktivitet bankar, shërbime financiare, shërbim postar, agjenci udhëtimi, agjenci imobiliare, shërbim i këmbimit valutor.	Vendimi i regjistrimit në gjykatë si Shoqëri Akti i themelimit Statuti i shoqërisë
c. Të jetë i regjistruar si shoqëri	Vërtetim i regjistrimit pranë organeve tatimore
d. Të mos ketë detyrime të papaguara në afat	Vërtetim nga organet tatimore dhe nga regjistri i kredive pranë Bankës së Shqipërisë
e. Të ketë të paktën një agjent të licencuar	Licenca e agentit, kontrata e punësimit me agentin
f. Të disponojë mjedisin dhe infrastrukturën e përshtatshme për të ushtruar veprimtarinë e agentit në sigurime (Zyrë e përshtatshme, e pajisur me kompjuter dhe akses për lidhje on-line me shoqërinë e sigurimit)	Dokument hipotekor për pronësinë e ambientit, kontratë qiramarrje, foto për ambientin dhe pajisjet e saj
g. Të ketë policë sigurimi për përgjegjësitë profesionale në një shumë jo më të vogël se 100 000 lekë për çdo ngjarje të siguruar ose jo më të vogël se 150 000 lekë në vit për të gjitha rastet e sigurimit	Polica e sigurimit
h. Të ketë një garanci financiare në masën 4% të shumës së primeve vjetore të mbledhura ose të paktën shumën prej 1 000 000 (një milion) lekë në një nga bankat e nivelit të dytë që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, në favor të shoqërisë së sigurimit më të cilën do të lidhë kontratën e agentit	Vërtetimi bankar
i. Drejtori i përgjithshëm dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës duhet të plotësojnë kriteret e besueshmërisë të cituara në gërmat b), c) d), e), f) dhe g) si në rastin e personit fizik	Shih dokumentacionin për personin fizik

- Kriteret dhe dokumentacioni që duhet të plotësojnë aplikuesit për licencë agjenti si **degë e shoqërisë së huaj të agentëve** janë si më poshtë:

Kriteret	Dokumenti
a. Formular kërkesën për pajisjen me licencë agentë në sigurime	Formular kërkesën e miratuar nga Autoriteti
b. Dokumenti mbi miratimin zyrtar për hapjen e kësaj dege dhënë nga autoriteti mbikëqyrës i vendit të origjinës	I përkthyer, i noterizuar dhe i vërtetuar me apostile

c. Dokumentin e regjistrimit të degës së shoqërisë së huaj të sigurimit si shoqëri anonime me seli qendrore në RSH	Vendimi i regjistrimit në gjykatë si Shoqëri Akti i themelimit Statuti i shoqërisë
d. Çdo informacion tjetër, të parashikuar në Ligj, në këtë Vendim për personin juridik dhe që kërkohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	

3. Procedurat për marrjen e licencës

- Kërkesa me shkrim për pajisje me licence agjenti vjen nga shoqëria e sigurimit në emër dhe për llogari të së cilës do veprojnë të licencuarit.
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga kërkuesi për licencë. Nëse në dokumentacion vërehen mangësi apo pasaktësi, kërkuesi njoftohet për plotësimin e tyre, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit.
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, pasi vlerëson se dokumentacioni është i plotë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit, jep ose refuzon licencën për ushtrim veprimtarie si agjent në sigurime.

4. Cilësitë e licencës për agjent në sigurime

Licenca për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime është:

- E përcaktuar sipas klasave të sigurimit,
- e patransferueshme,
- e patregtueshme,
- me afat 3 –vjet, me të drejtë rinovimi
- Vlefshmëria e licencës fillon pas lidhjes së kontratës me shoqërinë e sigurimit dhe instalimit të programit të shitjes on-line.

Subjekti i licencuar për veprimtari agjenti në sigurime, duhet të jetë lehtësisht i identifikueshëm nga publiku. Ai detyrohet të japë minimalisht emrin, mbiemrin dhe adresën ku ushtron veprimtarinë, dokumentin që vërteton se është i licencuar për të ushtruar veprimtari si agjent në sigurime, shoqërinë e sigurimit, për llogari të së cilës vepron si dhe afatin e vlefshmërisë së licencës.

Ky informacion duhet të jetë i dallueshëm, i qartë, i saktë dhe i kuptueshëm nga konsumatori dhe të përfshihet në shenjën dalluese të çdo agjenti të licencuar në sigurime që mbahet gjatë gjithë kohës së ushtrimit të veprimtarisë.